

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.04.2023*

18.04.2023
Ora, 10:03

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të shoqatës “Diaspora për Shqipërinë e lirë”, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Gjeorgjisë dhe organizatës “IRI” Shqipëri, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj**

• **Parti Politike:** **S’ka**

• **Të tjerë** **KRIIK, OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjesi atëhere, në seancën e sotme publike kemi në rend dite 5 çështje. Kemi shqyrtimin e kërkesave për akreditim të disa vëzhguesve të Organizatës Diaspora për Shqipërinë e lirë, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Gjeorgjisë dhe Organizatës “IRI”. Pastaj kemi shqyrtimin e kërkesës së Organizatave Diaspora Shqiptare dhe Qendra Rinore Hëna. Projektvendimi për caktimin e numrit rendor në fletën e votimit për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për anëtar të këshillit të bashkisë. Projektvendim për caktimin e numrit vendor në fletën e votimit për kandidatin për kryetar bashkie, zotin Kosta Garo nga Nisma Thurje për Bashkinë e Dropullit. Të mbartur kemi projektvendimin që lidhet

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.04.2023*

me dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendodhjes së disa qendrave të votimit, çështje e shtyrë.

Atëherë kalojmë me rradhë çështjet, pika e parë:

Z. Y. Merkaj: Shoqata “Diaspora për Shqipërinë e lirë” ka paraqitur kërkesën pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për akreditimin e 9-të vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Shoqata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” është subjekt zgjedhor i cili gëzon të drejtën të caktoj vëzhgus për zgjedhjet, përcaktuar sipas nenit 6 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Gjeorgjisë ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 4 vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Organizata “Iri” në Shqipëri ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 7 vëzhguesve afat shkurtër. Do të vlerësohet dhe kërkesat e këtyre organizatave. Plotëson dhe kriteret e parashikuara nënenit 6 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të miratohet. I propozojmë Komisionerit miratimin e këtyre vëzhguesve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, miratojmë kërkesat e këtyre organizatave për akreditim vëzhguesish, për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023.

Vendimi nr. 369

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



18.04.2023
Ora, 10:05

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të shoqërisë “Diaspora Shqiptare” dhe Qendrës Rinore “H.A.N.A”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj**

• **Parti Politike:** **S’ka**

• **Të tjerë** **KRIIK, OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Po, shoqëria “Diaspora Shqiptare” ka depozituar kërkesën për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gjithashtu Qendra Rinore “H.A.N.A” ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 7 vëzhguesve afatshkurtër. Kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga të dyja këto shoqata dhe qendra rinore plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe si të tilla duhet të miratohen. I propozojmë Komisionerit miratimin dhe akreditimin e këtyre vëzhguesve të këtyre shoqatave. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë, miratojmë edhe akreditimin e vëzhguesve për organizatën “Diaspora Shqiptare” dhe Qendrën Rinore “H.A.N.A”.

Vendimi nr. 370

Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI



18.04.2023
Ora, 10:06

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e numrit rendor në fletën e votimit për kandidatet e propozuar nga zgjedhësit për anëtar për këshillat e bashkisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- | | |
|---------------------------------------|----------------------|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Staf i KQZ: | Z. Y. Merkaj |
| • Parti Politike: | SKA |
| • Të tjerë: | KRIIK, OSBE/ODIHR. |

Z. I. Celibashi: Kalojmë ke pika e 3-të e rendit të ditës. Për caktimin e numrit rendor në fletën e votimit për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për anëtarët e këshillit të bashkisë.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator me vendim numër 8, datë 23.02.2023 ka përcaktuar procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletën e votimit në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Shorti përcakton numrin që duhet të mbajë subjekti zgjedhor në fletën e votimit. Në nenin 2, të vendimit numër 8 të Komisionit Rregullator është përcaktuar se në renditjen përfundimtare kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë vendosen pas renditjes së partive politike dhe koalicioneve zgjedhore. Në

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.04.2023*

rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen dy ose më shumë kandidat, propozuar nga zgjedhësit, renditja midis tyre përcaktohet me short. Në shortin e hedhur dhe nga kërkesat e paraqitura, janë paraqitur 40 subjekte zgjedhore dhe koalicione, kështu që referuar dhe nenit 2, të vendimit numër 8 të Komisionit Rregullator, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit do të renditen pas këtyre. Rezultati i shortit ka qënë numri 41 dhe numri 42 sipas kandidaturave të paraqitura në fletën e votimit. Bashkëlidhur keni dhe numrin rendor të kandidatëve për secilën fletë votimi. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Pra kandidatët e mbështetur nga zgjedhësi për anëtar këshilli do të kenë fletët e votimit numër 41 dhe numër 42 në të gjitha bashkitë.

Vendimi nr. 371

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



**18.04.2023
Ora 10:07**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e numrit rendor në fletën e votimit për kandidatin për kryetar bashkie, z. Kosta Garo, në Bashkinë Dropull, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”.

PJESËMARRJA :

• KQZ

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj

• Parti Politike: S’ka

• Të tjerë KRIIK, OSBE/ODIHR

Z. I. Celibashi: Dakord atëherë, kalojmë tek pika tjetër që ka të bëjë me projektvendimin për caktimin e numrit rendor në fletën e votimit për kandidatin për kryetar bashkie, zotin Kosta Garo në bashkinë Dropull, i propozuar nga subjekti zgjedhor “ Nisma Thurje”

Z. Y. Merkaj: Subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” ka propozuar për kryetar të Bashkisë Dropull, kandidaturën e zotit Kosta Garo. KZAZ-ja numër 82 ka vendosur mos regjistrimin si kandidat për kryetar bashkie Dropull. Gjithashtu ky vendim është lënë në fuqi dhe nga KAS-i. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” dhe Kolegji Zgjedhor në datën 15 prill 2023 ka vendosur pranimin e kërkesës. Shfuqizimin e vendimit numër 43 datë 3.04.2023 të Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve dhe vendimit numër 10, datë 23.08.2023 të KZAZ-së

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.04.2023*

numër 82 Dropull, detyrimin e KQZ-së / KZAZ-së numër 82 të regjistrohet si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull zotit Kosta Garo të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”. Duke qenë se KZAZ-ja nuk e ka marrë vendimin për regjistrim atëherë këtë detyrë do ta ushtrojë KQZ-ja si organi epror. Në këto kushte i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve regjistrimin e zotit Kosta Garo si kandidat për kryetar i Bashkisë Dropull. Propozuar nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Praktikisht do të bëjmë regjistrimin e këtij kandidati bazuar në autorizimin dhe urdhërimin që ka dhënë Kolegji Zgjedhor. Mirë atëherë vendosim:

- Regjistrimin e zotit Kosta Garo si kandidat për kryetar bashkie, në Bashkinë Dropull i propozuar nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
- Caktimin numri tre si numër rendor në fletën e votimit për këtë kandidat.

Vendimi nr. 372

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



18.04.2023
Ora, 10:09

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1796, QV nr. 1796/01, QV nr. 1796/02, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- | | |
|---------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Stafi KQZ: | Z. Y. Merkaj |
| • Parti Politike: | S’ka |
| • Të tjerë | KRIIK, OSBE/ODIHR |

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë, kalojmë tek pika e fundit rendit të ditës që ka të bëjë me dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendodhjes së disa qendrave të votimit.

Z. Y. Merkaj: Në mbledhjen e kaluar është relatuar ky projektvendim. Është lënë detyrë nga Komisioneri, por dhe një kërkesë nga Partia Demokratike për t’i parë dhe njëhere këto qendrat e votimit. Është kërkesë e njesisë administrative numër 4, e cila ka marrë autorizim nga kryetari i bashkisë Tiranë, për të përcaktuar vendodhjen e qendrave të votimit. Duke qenë se jemi më pak se 40 ditë para ditës së zgjedhjeve është bërë përsëri verifikimi i këtyre qendrave të votimit dhe konstatohet se në ambjentin privat ku është propozuar tek propozimi i parë i zotit Robert Bano nuk plotëson kushtet pasi është në fazën e karabinasë. Ambjenti tjetër i propozuar është i zotit Kastriot Isufaj, i cili ka qenë dhe ka shërbyer si qendër votimi edhe në

1

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.04.2023*

zgjedhjet e kaluara. I propozojmë Komisionerit miratimin e propozimit të kryetarit të njësisë administrative numër 4 duke dhënë autorizimin për qendrat e votimit numër 1796 qendra e votimit 1796/1 dhe qendra e votimit 1706/02. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive nuk sollën ndonjë mendim ose ndonjë vlersim të tyre?

Z. Y. Merkaj: Deri më sot nuk kemi asnjë vërejtje.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, vendosim dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendodhjes së qendrës së votimit numër 1796 qendrës së votimit 1796/01 dhe qendrës së votimit numër 1796/02 në ambientin përkatës privat. Ndërkohë ngarkohet dhe administratori i njësisë administrative që të afishojë listat e zgjedhësve në këtë objekt. Mirë dakord, seanca mbyllet!

Vendimi nr. 373

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

